



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 9 paragrafi 1.7 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, si dhe neneve 14 dhe 15 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/19, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në propozim të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, në mbledhjen e mbajtur më 29 shtator 2022, mori,

VENDIM PËR MIRATIMIN E PLANIT TË PUNËS TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2022

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në Komunën e Podujevës, për vitin 2022.

Neni 2

Plani i Punës sipas nenit 1, është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr.Prot. 01-016/01-0084069/22
Podujevë, datë, 29.09.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

PLANI I PUNËS SË
KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Përmbledhje:

Në takimin e parë (1), themelues të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, të mbajtur me datë: 8 qershor 2022, në rendin e ditës u përcaktua hartimi i dy (2), dokumenteve: i. Raporti i Punës për Vitin 2021 dhe Plani i Punës për vitin 2022. Në hartimin e Planit të Punës (2022), anëtarët, miratuan propozimin që ky grup të udhëhiqet nga përfaqësuesi i shoqërisë civile.

Plani ka tri dimensione që do të shtrihen në një kornizë logjike, duke përfshirë: ndërlihdjen mes problemit, objektivave/veprimeve dhe aktorët e përfshirë, në një agjendë/plan pune vjetor. Nëpërmjet këtij plani synohet të integrohen politikat, veprimet dhe financimit në fushën e sigurisë publike. Plani, merr parasysh kompleksitetin e sigurisë publike, duke mos u kufizuar vetëm në mekanizmat përgjegjës të sigurisë (Policinë, Forcat e Sigurisë, KFOR dhe Emergjencat), por i jep formë ndër-veprimit institucional dhe publik, në përmirësimin e faktorëve rrethorë që ndikojnë direkt apo tërthorazi sigurinë publike.

Në rend të parë plani synon përmirësimin e koordinimit mes mekanizmave institucional; dhe në rend të dytë, forcimin e komunikimit dhe bashkëpunimit me palët tjera. Tek koordinimi institucional, merren parasysh, infrastruktura, shërbimet dhe mekanizmat institucional, që nëpërmjet ndër-veprimit, shmangin fragmentimin, duplikimin e politikave dhe financimeve. Përderisa, tek mekanizmat publik, marrin parasysh akterët si: bashkësitë fetare, komunitetin e biznesit; shoqërinë civile; grupet e marxhinalizuara dhe përgjithësisht qytetaret, që nëpërmjet përfshirjes mund të kontribuojnë në identifikimin, artikulumin dhe adresimin e problemeve në komunitet.

Përgjatë këtij viti (2022), synohet të ndërtohen praktika dhe modele të reja të bashkëpunimit dhe kontributit të ndër-sjellë në mënyrë që të rritet ndikimi dhe progresi në sigurinë publike. Siguria publike dhe kontributi akterëve/komunitetit, janë të lidhura reciprokisht me njëra tjetrën, sa më shumë që rritet kontributi, aq më shumë rriten mundësitë për një ambient të sigurte publik.

Ky plan pune, do të përmbajë: çështjet kryesore për trajtim; objektivat; veprimet si dhe përfshirjen e aktorëve instucional dhe publik. Plani do shtrihet në katër komponentë:

- Analizën e problemit;
- Objektivat/Veprimet;
- Aktorët e përfshirë; si dhe
- Monitorimin, vlerësimin e përmbushjes dy periudha gjashtë (6) mujore;

Ky plan, do ti shërbej KKSB, si agjendë e qartë e angazhimit për interes publik; palëve tjera si mundësi për kontribut; qytetarë, mediave dhe shoqërisë civile, si mundësi informimi, por edhe njohje dhe kontributi për çështjet. Ndërkaq, për gjithë procesin, zbatimin e tij, do të rriste standardet në fushë, duke konsoliduar praktika inovative, ofruar modele të avancuara dhe duke hapur shtigje të reja për gjetjen e zgjidhjeve të qëndrueshme për problemet e sigurisë publike.

Analiza e problemi:

Mjedisi i përgjithshëm publik/sfida kryesore;

Përkundër se në raportet e rregullta, konstatohet se gjenda e sigurisë vlerësohet pozitivisht nga mekanizmat e sigurisë, ekzistojnë disa faktorë që ndikojnë që në mjedisin publik, cenojnë, pengojnë apo vështirësojnë sigurinë publike siç mund ti listojmë disa nga ta: rreziku nga qenët endacak, vjedhjet, dhuna në familje, posedimi dhe armëmbajtja pa leje, siguria në shkolla, cenimi i sigurisë nga konfrontimet fizike; dëmtimet e pronës publike/ambientit; zjarrvënëset e pyjeve, komunikacioni si dhe rreziqet nga vërshimet. Përgjithësisht, mund të vlerësohet se ekzistojnë mekanizma të dobët në artikulum (mbledhje të kërkesave), si dhe adresim të tyre. Për shumicën nga këto probleme, ekziston një paqartësi në veprime të integruara, forma standarde të adresimit si dhe komunikim i fragmentuar mes institucioneve dhe me qytetarët.

Infrastruktura, shërbimet dhe institucionet publike;

Mund të vlerësohet se shtrirja e infrastrukturë, institucioneve dhe shërbimeve publike, ka arritur nivele të larta, megjithatë ende ka probleme që determinojnë sigurinë publike nisur nga:

Infrastruktura:

Mungesa e trotuareve në disa hapësira, mungesa e ndriçimit publik, qasjet e rrezikshme (pa dukje, pa sinjalistikë) në disa rrugë; parkingjet të pa ligjshme dhe uzurpimi i hapësirave publike (trotuareve, parqeve), mungesa e kontrollit të shpejtësisë në rrugë (radarëve statik), shtrirja dhe kontrolli i ulët i kamerave të sigurisë; funksionimi i operatorëve ilegal (taksi, shitës, transportues); mungesa e kufizimeve, siguria afër lumenjve/apo vendeve me rrezik; mungesa e urave; si dhe sinjalistikës adekuate;

Shërbimet:

Qasja e ulët në sistemin e ujit të pijshëm/puset e kontaminuara; derdhja/ndotja e lumenjve; qasja jo e plotë në sistemin e mbeturinave; mungesa e deponisë inerte dhe të mbetjeve shtazore; mungesa e mirëmbajtjes së hapësirave publike, si rrugëve, ndërtesave, oborreve publike dhe parqeve; qasja e dobët në transportin publik (pa stacione, pa standard të mjeteve, si dhe pa qasje disa zona); mungesa e vend parkingjeve; qasja e vështirë në institucione publike, shkolla, shërbime shëndetësore (në veçanti urgjenca) si dhe në vetë institucionin e komunës (me theks për personat me nevoja të veçanta); mungesa e kontrollit/vlerësimit të sigurisë në objekte kolektive, shkolla, spitale dhe banim kolektive; mungesa e kontrollit të rregullte tregut dhe ushqimit.

Kapacitetet institucionale në menaxhimin e sigurisë publike;

Përkundër se mund të vlerësohet lartë, shërbimi i mekanizmave të sigurisë publike dhe ato të emergjencave, mund të konstatohen tri, probleme kyçe që në baza të rregullta ata ballafaqohen: mungesë të stafit, paisjeve dhe financimeve të qëndrueshme. Shpesh, kjo kur kombinohet edhe me problemet tjera zinxhirë të renditur më lartë rritet barra për shërbyesit e sigurisë dhe emergjencave.

Plani i reagimit emergjent dhe pikat kritike të rrezikut;

Komuna, bazuar në Planin Kombëtarë të Emergjencave, duhet të hartoj Planin e Reagimit Emergjent, ku përfshihen aspektet kryesore si: pozicioni i komunës; infrastruktura; të dhëna statistikore; pajisjet e sigurisë; mekanizmat; kapacitete e operatorëve; plani i reagimit, komunikimit, ndërlihdjes si dhe të dhëna statistikore si numri i banorëve, nxënësve, personelit.

Ky dokument, poashtu duhet të parashoh edhe veprimet afat-shkurta dhe afat-mesme që do të adresojnë zvogëlimin/uljen e rreziqeve përmes investimeve publike, pikat kritike të rreziqeve, ngritjen e kapaciteteve të emergjencave, planet e reagimit, si dhe testimin e gatishmërisë. Në, eliminimin e pikave kritike të rreziqeve, KKSBB duhet të reflektojë, nga plani, kontributi i anëtarëve dhe diskutimet me aktorë, qytetarët, për ti priorizuar në investimet publike.

Koordinimi ndër-institucional;

Mungesa e koordinimit ndër-institucional, në një plan të integruar shpesh nuk merr parasysh dimensionin e gjerë të problemeve, qoftë në investimet në infrastrukturë, ofrim të shërbimeve apo edhe inspektime të rregullta. Në shumë raste, veprimet ad-hoc, nuk adresojnë mjaftueshëm eliminimin e sfidave, apo në disa raste prodhojnë sfida të reja. Si, shembull, rregullimi i orientimit të rrugëve (rritja e frekuencës), mund të shtojë rrezikun për fëmijët tek shkollat; apo në raste të caktuara mungesa e koordinimit të orarit të transportit me orarin e shkollave. Në disa, raste dy, ose më shumë dikastere, apo operatorë bëjnë punë të dyfishta, apo copëzim të investimeve, kështu shkaktojnë rreziqe, si rastet e vendosjes së rrjetit të energjisë, ujësjellësit, kanalizimeve, apo punëve tjera publike.

Koordinimi me aktorët publik dhe qytetarët;

Në mungesë të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane, por edhe të platformave të komunikimit të rregullt, disa çështje publike, nuk arrijnë ose të adresohen mjaftueshëm, apo një politikë, apo mesazh institucional të përçohet, kuptohet mjaftueshëm. Për këtë ekziston nevoja që të sigurohen, një konsultim, koordinim dhe bashkëpunim më i mirë. Kjo, do të mundësonte, ndër-veprimin e aktorëve në një agjendë, siç është rasti i debateve, trajnimeve për edukimin, në parandalimin e dukurive devijonte, sigurinë në shkolla, parandalimin e zjarrëvënjeve, ndotjes së ambientit, dëmtimit të pronës publike. Një koordinim më i mirë, do të forconte rolin e aktorëve, duke rritur edhe potencialin për ndryshim.

Podujevë,
29.09.2022

 Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha

Nr.	Objektivi	Veprimet	Aktorët institucional dhe publik të përfshirë	Ndërlidhja strategjitet, politikat/rregullativa; si dhe financimin;	Periudha /afatet
1	Vlerësimi i mjedisit publik nga aspekti i sigurisë;	<ul style="list-style-type: none"> - Punëtori e përbashkët me akterët; - Identifikimi i problemeve kyçe; 	<ul style="list-style-type: none"> - KKSBB - Përfaqësuesit lokal; - Përfaqësuesit e Sh.C; 	<ul style="list-style-type: none"> - Plani i reagimit emergjent; - Pikat kritike të rrezikut; 	Qershor – Korrik;
2	Hartimi i listës së prioriteteve për investime dhe adresimi në projekt-buxhetin komunal 2023;	<ul style="list-style-type: none"> - Konsultimi i planit të reagimit; - Kërkesave të qytetarëve; si dhe - Pikave kritike të rrezikut; 	<ul style="list-style-type: none"> - KKSBB; - Përfaqësuesit e komuniteteve lokale; dhe - SH.C; 	<ul style="list-style-type: none"> - Projekt Buxheti Komunal; 	Korrik – Gusht
3	Vlerësimi i listës së investimeve publike, nga këndi i elementeve të sigurisë;	<ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi i plotësimeve, rekomandimeve për rritjen e sigurisë nga investimet kapitale 	<ul style="list-style-type: none"> - KKSBB; - Akerët 	<ul style="list-style-type: none"> - Lista e investimeve kapitale; 	Shtator;
4	Vlerësimi i shërbimeve publike; nga këndi i sigurisë publike;	<ul style="list-style-type: none"> - Hapsirat publike; - Ndërtesat publike; - Ndërtesat kolektive; 	<ul style="list-style-type: none"> - KKSBB; - Komuna; - Akterët; - Ndërmarrjet publike; 	<ul style="list-style-type: none"> - Shërbimet publike; dhe ndërmarrjet publike; 	Tetor
5	Vlerësimi i planit të reagimit emergjent; vlerësimi i pikave kritike të rrezikut;	<ul style="list-style-type: none"> - Analiza e planit; - Analiza e pikave kritike të rrezikut; 	<ul style="list-style-type: none"> - KKSBB; - Komuna; - Akterët; 	<ul style="list-style-type: none"> - Emergjencat dhe reagimi; 	Nëntor;
6	Punëtori e akterëve institucional, për koordinim;	<ul style="list-style-type: none"> - Diskutim mbi planet; - Identifikimi/ndërlidhja e politikave; 	<ul style="list-style-type: none"> - KKSBB; - Komuna; - Ndërmarrjet; 	<ul style="list-style-type: none"> - Planet komunale; 	Dhjetor
7	Punëtori mes akterëve institucional dhe publik	<ul style="list-style-type: none"> - Hartimi i agjendës/planit të përbashkët 	<ul style="list-style-type: none"> - KKSBB; - Komuna; - Akterët publik 	<ul style="list-style-type: none"> - Bashkëpunimi i komunës/konsultimi; 	Dhjetor

KALENDARI I AKTIVITETEVE TË RREGULLTA

	AKTIVITETI	RAPORTUESI I AKTIVITETIT	BARTESI I AKTIVITETIT	PERIUDHA
1	Informatë nga Policia për gjendjen e sigurisë në komunë;	Komandanti i Stacionit të Policisë;	Anëtarët e KKSBB;	Në çdo takim
2	Informatë nga KFOR-i për sigurinë në komunë;	Përfaqësuesi i KFOR-it;	Anëtarët e KKSBB;	Sipas nevojës
3	Informatë nga FSK-së për sigurinë në komunë;	Përfaqësuesi i FSK-së;	Anëtarët e KKSBB;	Sipas nevojës
4	Miratimi i Planit vjetor të punës për 2022 në KKSBB;	Komisioni hartues;	Anëtarët e KKSBB;	Korrik
5	Miratimi i Planit vjetor të punës për 2022 në Kuvendin Komunal;	Kryesuesi i KKSBB;	Anëtarët e KKSBB;	Korrik
6	Miratimi i Informatës për punët dhe aktivitetet për 2021 në KKSBB;	Komisioni hartues;	Anëtarët e KKSBB;	Korrik
7	Informatë e zbatimit të Planit vjetor të punës për 2021 në KK;	Kryesuesi i KKSBB;	Anëtarët e KKSBB;	Korrik
8	Informatë për planin e Reagimit Emergjent;	Kryesuesi i KKSBB; Drejtori i DSHPMSh; Komandanti i Policisë; i DSHPMSh; DSHMS;	Shefi Drejtoria e Anëtarët e KKSBB;	Korrik
9	Informatë për sigurinë në shkolla;	DKA; Komandanti i Policisë;	DKA; Policia e Kosovës;	Shtator - Tetor
10	Informatë për pandemin Covid 19;	Drejtoria e Shëndetësisë	Drejtoria e Shëndetësisë; Shtabi i Emergjencës;	Shtator
11	Informatë rreth zbatimit të Planit operativ lokal sipas Strategjisë për parandalimin ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm;	Drejtori i DKA-së; Komandanti i Policisë; Krytari KBI;	DKA; Policia; KBI; DSHMS;	Tetor
12	Tryezë Pune me akterët;	Drejtori i DKA-së; Komandanti i Policisë; Krytari KBI; Përfaqësues nga Drejtoria kundër terrorizmit, OSHC;	KKSBB/OSHC;	Tetor
13	Masat parandaluese dhe sensibilizimi i qytetarëve për pasojat nga zjarri gjatë periudhës së korrije-shirjeve dhe djegieve të pyjeve, dhe vershimeve (koordinimi i aktivitetëve në mes DBPZHR, DSHPMSh, SZSH, Policisë, Agjencionin Pyjor, Agjencionin e Menaxhimit Emergjent;	Drejtori i DBPZHR; Komandanti i Policisë; Drejtori i DSHPMSh;	DSHPMSh, DI, APK, AME;	
14	Informatë nga SHZSH për intervenimet dhe gatishmërinë në rastet kundër zjarreve dhe intervenimet tjera;	Drejtori i DSHPMSh; Shefi i SHZSH;	DSHPMSh; SHZSH;	Korrik-Gusht
15	Informatë dhe diskutim për projektet (të infrastrukturës dhe të shërbimeve) që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve, që mund t'i propozohen drejtorive për miratim në Kuvendin Komunal, gjatë periudhës së miratimit të buxhetit të komunës;	Anëtarët e KKSBB;	Anëtarët e KKSBB; Drejtoritë;	Korrik-Gusht
16	Informatë për gjendjen e pyjeve;	Drejtori i DBPZHR;	DBPZHR; Policia e Kosovës; APK	Shtator

17	Informatë për dukuritë negative dhe masat sensibilizuese kundër këtyre dukurive; Përdorimi i narkotikëve, vjedhjet, dhuna në familje etj.);	Komandanti i Policisë; Drejtori i DSHMSH-së; Drejtori i DKA;	Komandanti i Policisë; Drejtori i DSHMSH-së; Drejtori i DKA;	Shtator - Tetor
18	Informatë për ambientin (realizimi i këtij aktiviteti të bëhet në natyrë);	Drejtori i DUPM-së dhe Drejtori i DSHMSH-së;	Drejtori i DUPM-së; Drejtori i DSHMSH-së	Korrik shtator
19	Informatë për sigurinë në komunikacion dhe trajtimi i qenëve endacak;	Policia, DI, DSHPMSH;	Policia, DI, DSHPMSH;	Korrik - Tetor
20	Informatë për rastet e ngritjes së shkallës së gatishmërisë në situatat emergjente,nëse paraqiten gjatë vitit;	Kryetari i Komunës, Komandanti i Policisë, Drejtori i DSHPMSH;	Policia e Kosovës,Shërbimi Zjarrfikës, DSHPMSH	Sipas nevojës
21	Gadishmëria për reagim në raste Emergjente Testimi me akterët(simulimi I reagimit dhe kordinimi i aktereve;	Kryetari i Komunës; Drejtori i DSHPMSH;	Akteret e perfshire ne reagimin emergjent	Nëntor
22	Informatë për rastet e kthimit dhe integritit të qytetarëve në shtëpitë(pronat) e tyre;	Zyrtari për integritet; Zyrtari për kthim dhe komunitete;	ZI, ZKK	Dhjetor
23	Takime te jashtëzakonshme(në rastet e paraqitjes së rasteve emergjente dhe raportime nga sherbimet përkatëse),përveç 6 takimeve tjera obligative;	Kryetari i Komunës Drejtoritë përkatëse; Komandanti i Policisë;	Anëtarët e KKSBB	Sipas nevojës
24	Diskutim rreth perdorimit të mjeteve pyroteknike;	Inspekcioni, Policia, FSK;	Inspekcioni, Policia	Dhjetor
25	Përveç temave të parapara me Plan, kryetari i komunës dhe anëtarët e KKSBB mund të propozojnë edhe tema të tjera të veçanta në sferën e sigurisë publike në komunë;	Anëtarët e KKSBB;	Anëtarët e KKSBB	Sipas nevojës
26	Formimi i Grupit punues për përgatitjen e Planit të Punës 2023; Formimi i Grupit punues për përgatitjen e Informatës për punën e KKSBB për 2022.	Kryesuesi i KKSBB;	Anëtarët e Grupeve	Dhjetor